



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**BASHKIA TIRANË
AGJENCIA E PARQEVË DHE REKREACIONIT
DREJTORIA E PROKURIMIT PUBLIK**

Data 28.08.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-Sherbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “SHPENZIME PËR QIRAMARRJE APARATE DHE
PAISJE TEKNIKE, MAKINERI”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Projektor 30191200-6, Projektor per video 38652120-7 , Karrige 39112000-0

VLERA E FONDIT LIMIT:

3,491,667 (tremilion e katërqind e nentëdhjetë e njëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) leke pa tvsh Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor **Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës8,*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik...”.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; perkatesisht në vleren **69,833.34** (gjashtëdhjetë e nentemijë e teteqind e tridhjetë e tre pike tridhjetë e kater)leke të lëshuar në formën e garancisë bankare ose nga shoqëri sigurimesh të licensuara nga Autoritetet përkatëse.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 83 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 30, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se:

“...Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël...”

“...Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe...”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.3. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% vlerës e fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, sa 40 % vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, i ndryshuar në të cilin përcaktohet se:

”1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës.

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse autoriteti jonë kontraktor kërkon që të garantohet se operatori ekonomik ofertues e ka kapacitetin ekonomik të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, njësia e prokurimit vendosi që të hartonte dhe përcaktonte këtë kërkesë për kualifikim.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit “Procedure e Hapur e thjeshtuar” ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 43, pika 1 e 2 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe Kreut II “Kufijtë monetarë” të VKM nr. 291, datë 15.05.2024 “Për përcaktimin e kufijve monetare në procedurat e prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare

Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, ne procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...;

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.;

KREU II

KUFIJTË MONETARË NË SEKTORIN KLASIK

1. Kufiri i lartë monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 603 000 000 (gjashtëqind e tre milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë.

2. Kufiri i ulët monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

Lidhur me vitet financiare për të cilat kërkohet që të jetë e realizuar xhiro e kërkuar, njësia e prokurimit duke ju referuar përcaktimeve të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 15.06.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku është përcaktuar se deklarata e xhiros vjetore mund të kërkohet deri në tre vitet e fundit financiare, si dhe nisur nga përcaktimi i pikës 7 të Rekomandimit të APP Nr.7998 datë 24.12.2021 "Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime" ku përcaktohet se në nenin 19 të ligjit nr 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, deklarata vjetore e të ardhurave nga subjektet tatim paguese deklarohet në organe tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, prandaj njësia e prokurimit meqënëse procedura e prokurimit do të zhvillohet në korrik të vitit 2025 dhe tatimpaguesit kanë afat deri më 31 mars 2025 të deklarojnë xhiron e realizuar në vitin 2024 përcaktoi si 3 (tre) vite të fundit financiare vitet 2022, 2023 dhe 2024.

Lidhur me vlerën e xhiros vjetore të përcaktuar, meqënëse procedura e mësipërme e prokurimit është nën kufirin e ulët monetar u përcaktua që vlera e xhiros vjetore të jetë sa 40% e vlerës së fondit limit.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2022, 2023, 2024) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat",

i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025 ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Njesisë së Qeverisjes Vendore ku operatori ekonomik ka selinë.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. *Dokumentacioni provues, për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje me nenin 76, pika 2, gërma b të LPP, i ndryshuar si dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2025 në të gjitha vendet ku ushtron aktivitet ekonomik sipas të dhënave të QKB-së.

2.3 Për kapacitetin teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate konkretisht: **698,333.4 (gjashtëqind e nentëdhjetë e tete mijë e treqind e tridhjetë e tre pike kater) Lekë pa tvsh.**Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për shërbime të mëparshme të ngjashme të realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e suksesshëm të kësaj kontrate ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të ngjashme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4, germa (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlogaritur të fondit limit për këtë lot. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e

2.3.2 Operatori Ekonomik me ane të nje deklarate të sigurojë kryerjen e transportit të të gjitha pajisjeve teknike në destinacionin ku do të zhvillohet aktiviteti dhe largimin e tyre pas mbarimit të aktivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” nenin 41 pika 6 ku citohet: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë dhe mbajnë përgjegjësi për kryerjen e shërbimit për permbushje me suksese të kontrates objekt prokurimi.

2.3.3 Operatori ekonomik të marrë përsipër me ane të nje deklarate montimin, përdorimin dhe çmontimin e të gjitha paisjeve teknike nga stafi i tij.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” nenin 41 pika 6 ku citohet: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë dhe mbajnë përgjegjësi për kryerjen e shërbimit për permbushje me suksese të kontrates objekt prokurimi.

Specifikimet teknike

Shërbimi	TERMAT E REFERENCES
Foni 10 000 Watt, aktivitete (foni e kompletuar me bokse pasive, aktive, monitora zëri, mikrofona instrumentash, mikser fonie, amplifikatorë të fuqishëm, mikrofona Wireless handheld (akullore), stativë mikrofoni me këmbë të palosshme, kablla korenti, foltore, etj)	Boks pasiv me mundësi për t'u varur (sistem Line Array): Boks pasiv 2 rrugësh me dy Bokse me përmasa 8" secili për frekuencat e ulëta dhe një Boks me përmasa 3" i kompresuar për frekuencat e larta. Të ketë fuqi të pakën 350 watt. Boksi të vijë në formë "Line Array", me të gjithë aksesorët e nevojshëm për ta varur në lartësi dhe për të kombinuar të paktën 12 copë së bashku. Këndi i mbulimit horizontal për frekuencat e larta të ketë të paktën tre mundësi zgjedhje, 110 gradë, 70 gradë dhe 90 gradë. Elementet e varjes së boksit duhet të lejojnë zgjedhjen e të paktën tetë këndeve të ndryshme kur bokset montohen njëri pas tjetrit. Kasa e boksit duhet të jetë e përbërë nga material druri dhe të jetë e durueshme ndaj ujit me nivel izolimi të paktën IP55. Amplifikator fuqie për foni të varur sistem Line Array. Amplifikator digjital që të ketë të paktën 4 hyrje sinjali dhe 4 dalje fuqie me të paktën 3300 watt RMS për secilën dalje në rezistencën 2.7 ohm dhe të paktën 2600 watt RMS në rezistencën 4 ohm. Amplifikatori të suportojë të paktën dy hyrje sinjali digjitale të standartit AES/EBU. Amplifikatori të ketë të integruar një sistem digjital për menaxhimin e sinjalit audio dhe procesimin e tij. Arkitektura e amplifikatorit të jetë e klasit D dhe të suportojë frekuencat të paktën nga 20 Hz deri në 20 kHz. Amplifikatori të ketë aftësinë për t'u kontrolluar totalisht në distancë me anë të një software kompjuterik që lejon ndryshimin e parametrave në kohë reale dhe monitorimin e të gjithë parametrave. Procesori i integruar të jetë i tipit 32-bit dhe me sampling rate 96 kHz. EQ e integruar të ketë të paktën 8 filtra IR dhe 3 filtra FIR. Të ketë limiter të integruar që ndihmon në mbrojtjen e bokseve. Amplifikatori duhet të ketë një ushqyes universal që lejon të funksionojë në një brez të gjerë voltazhi të rrymës elektrike e cila duhet të jetë të paktën ndërmjet 100 Volt deri në 240 Volt. Boks aktiv për muzikë dhe monitor skene: Boks aktiv dy rrugësh, me funksion për monitor skene. Të ketë një amplifikator të integruar me fuqi të paktën 400 Watt RMS i klasit D. Boksi të ketë një Boks për frekuencat e ulëta me përmasë 10" dhe një Boks për frekuencat e larta me përmasë

të paktën 1". Boks i frekuencave të larta të jetë i montuar në formë koaksiale në atë të frekuencave të ulëta. Hinka e Bokst të frekuencave të larta të jetë e rrotullueshme për të krijuar këndet 90x60 gradë ose 60x90 gradë (Horizontalisht/Vertikalisht). Boksi të ketë të integruar një procesor digjital për ekualizimin e tingullit. Në panelin e kontrollit të ketë mundësinë për të zgjedhur të paktën dy presete të gatshme për performancë Live dhe Playback. Gjithashtu procesori të ketë të integruar një limiter automatik për mbrojtjen e boksit. Brezi i frekuancave që boksi duhet të arrijë të riprodhojë të jetë të paktën 60 Hz deri në 19 KHz. Niveli i presionit të zërit të jetë të paktën 128 dB. Boksi të ketë të paktën një konektor XLR të balancuar për hyrjen e sinjalit dhe një konektor XLR të balancuar për daljen e sinjalit. Konektori për hyrjen e sinjalit të ketë mundësinë që të konfigurohet për hyrje mikrofonike ose Line.

- **Boks aktiv me frekuencë të ulët:** Boks aktiv me frekuencë të ulët me fuqi 1600 Watt tipi 2. Boks aktiv me frekuencë të ulët me amplifikator të klasit D të integruar dhe fuqi minimalisht 1600 watt rms. Përmasat e Boksit të jenë 18". Boksi të jetë i përshtatshëm për t'u varur në lartësi (Line Array) dhe të vijë me të gjithë aksesoret e nevojshëm që sigurojnë montimin e tij në skenë. Brezi i frekuencave që boksi duhet të arrijë të riprodhojë të jetë të paktën 35 Hz deri në 110 Hz. Niveli i presionit të zërit të arrijë të paktën 139 dB. Ushqyesi i amplifikatorit të boksit të jetë i tipit SMPS me voltazh 100V ~ 240V dhe frekuencë 50 ~ 60Hz.
- **Boks pasiv me frekuencë të ulët me mundësi për t'u varur (Line Array):** Subwoofer me dy Bokse 18 inç me drejtues ekskursioni të lartë dhe ajrim laminar të optimizuar për të maksimizuar efikasitetin LF - i vendosur në modele të gjithëdrejtimit ose kardiod në konfigurime të grumbulluara ose të fluturuara.
- **Boks pasiv me vizualitet të ulët:** Boks pasiv dy rrugësh me një Boks 5" për frekuenca të ulëta si dhe një Boks me përmasa të paktën 1", i kompresuar, për frekuencat e larta. Boks i frekuencave të larta të jetë i montuar në formë koaksiale me Boksin e frekuencave të ulëta. Kasa e boksit duhet të jetë e përbërë nga material druri dhe pjesa përpara Boksit të ketë një rrjetë metalike e cila është e trajtuar për të rezistuar

	hyrjen e grimcave të ngurta, me një nivel izolimi të paktën iP30. Boksi duhet të riprodhojë një brez frekuencash ndërmjet 95 Hz në 20 kHz dhe të ketë një mbulim të paktën 110 gradë. Boksi të ketë fuqi të paktën 60 Watt. • Pult fonie digjital me 96 kanale. Mikser audio digjital i pajisur me 3 ekrane, me prekje 12 inch, me mundësi vizibiliteti në dritën e diellit. Mikseri të jetë i pajisur 24 + 2 shina të motorizuara. Mikseri duhet të pranojë deri në 192 hyrje dhe 28 dalje. Mikseri të ketë mundësi hyrje të paktën 5 porta USB 2.0, 2 porta ethernet dhe 1 fibër. Të krijojë mundësinë e regjistrimit deri në 128 audio njëkohësisht. • Mikrofon valor : Mikrofon valor që përdoret për fjalime dhe muzikë. Mikrofonit të vijë bashkë me bazën që shërben për marrjen e sinjalit. Baza duhet të suportojë të paktën 2 mikrofona që funksionojnë njëkohësisht. Sistemi valor duhet të jetë tërësisht digjital. Mikrofonit duhet të suportojë inkriptimin e sinjalit të transmetuar me kapacitetin 512-BIT. Baza e mikrofonit, veç daljes analoge të sinjalit, duhet të ketë edhe dalje digjitale si DANTE dhe AES EBU. Brezi i frekuencave që duhet të suportojë mikrofonit: 25 – 20 000 Hz. • Mikrofona vokali me kabëll: Mikrofon vokali me kabëll: Mikrofon vokali dinamik me kabëll. Polariteti super kardiod. Brezi i frekuencave 50 Hz – 16 kHz. Mikrofonit të jetë i përshtatshëm për t'u përdorur në koncerte dhe këngëtarë live. • Mikrofon instrumenti. Mikrofon për instrument frymor që mund të kapet në instrument. Mikrofonit të jetë me kondensator dhe të funksionojë me 9 deri në 52 volt. Brezi i frekuencave që duhet të funksionojë: 60 - 20 kHz. Polariteti të jetë kardiod. • Set mikrofonash për bateri : Seti i mikrofonave për bateri të përbëhet nga të paktën 7 mikrofona që të shërbejnë për të kapur një gamë të gjerë instrumentesh si drum, bas drum, overhead për baterinë dhe mikrofon për amplifikatorë kitare. • Mikrofon foltoreje: Mikrofon për foltore me gjatësi 40cm. Kapsula e mikrofonit të jetë e çmontueshme për të mundësuar instalimin e disa kapsulave të ndryshme. Mikrofonit të shoqërohet me kapsulë kardioide dhe super kardioide. • Mikrofon për prezantues: Mikrofonit për prezantues është i
--	---

	montueshëm në pjesën e kokës. Të ketë të paktën dy kapje që mbështeten në vesh. Mikrofonit dhe kapsulës të kenë ngjyrë bezhë të hapur. Polariteti i kapsulës të jetë super kardiod. Mikrofonit të shoqërohet me një transmetues valor që montohet në trup dhe një marrës valor që shërben për marrjen e sinjalit të transmetuar. • Përforcues sinjali audio: Përforcuesi i sinjalit audio të ketë të paktën dy hyrje Jack ¼” dhe një hyrje XLR. Përforcuesi duhet të stabilizojë dhe balancojë sinjalin audio që vjen direkt nga instrumentet muzikore. • Shpërndarës sinjali audio: Shpërndarës sinjali fonie digjital me të paktën 32 kanale hyrëse dhe 16 kanale dalje. Të ketë të paktën 2 dalje digjitale AES/EBU me konektorë XLR të balancuar. Secili kanal hyrës, me konektorë XLR të balancuar, të ketë opsion për aktivizim fuqie +48V për mikrofonat që kërkojnë “phantom power”. • Set pajisjesh për DJ. Set pajisjesh për DJ për performancë e DJ (cd player + mixer) • Foltore e branduar. Foltore transparente, e cila të ofron mundësinë e brandimit sipas dizajnit të Autoritetit Kontraktues, e përshtatshme për fjalime dhe evente të kategorive të ndryshme.
Foni 5000 Watt, aktivitete (foni e kompletuar me bokse pasive, aktive, monitora zëri, mikrofona instrumentash, mikser fonie, mikrofona Wireless handheld (akullore), stative mikrofoni me këmbë të palosshme amplifikator, kablla korenti, etj)	• Boks aktiv për muzikë: Boks dy rrugësh aktiv me frekuencë të ulët 15” dhe frekuencë të lartë 1.4” me fuqi 900 watt, me amplifikator të integruar të klasit D me fuqi minimalisht 900 watt rms. Të ketë mundësi kontrolli me RDNet me program kompjuterik për analizën e frekuencave dhe optimizimin e sistemit në distancë. • Boks aktiv për fjalim: Boks dy rrugësh me Boks 10” dhe frekuencë të lartë 1” me amplifikator të integruar. Boksi të ketë fuqi të paktën 500 watt dhe nivel decibel të paktën deri në 122dB. • Pult fonie digjitale me 32 kanale: Pult fonie digjital. Pulti duhet të ketë të paktën 32 hyrje mono, si dhe 32 shina të motorizuara. Pulti të ketë 32 hyrje dhe 16 dalje analoge. Pulti duhet të kontrollohet me protokollin Dante Controller. Pulti të shoqërohet me një “stagebox” (pajisje për ndërlidhje sinjali) i cili krijon mundësi për të shtuar dhe 32 hyrje dhe 16 dalje. Pulti të ketë të integruar një ekran digjital me anë të të

	cilit të kontrollohen dhe të rregullohen parametra të ndryshëm. Pulti të krijojë mundësinë që të kryejë regjistrim multi-track me 32 kanale. Pulti duhet të krijojë mundësi për procesim zëri në çdo hyrje dhe dalje. • Mikrofon vokali me kabëll: Mikrofon vokali dinamik me kabëll. Polariteti super kardiod. Brezi i frekuencave 50 Hz – 16 kHz. Mikrofonit të jetë i përshtatshëm për t'u përdorur në koncerte dhe këngëtarë live. • Set pajisjesh për DJ. Set pajisjesh për DJ për performancë e DJ (cd player + mixer)
Foni 3000 Watt, aktivitete (foni e kompletuar me bokse pasive, aktive, monitora zëri, mikrofon instrumentash, pult fonie, amplifikator, kablla korenti, etj)	• Boks aktiv për muzikë: Boks dy rrugësh aktiv me frekuencë të ulët 15" dhe frekuencë të lartë 1.4" me fuqi 900 watt, me amplifikator të integruar të klasit D me fuqi minimalisht 900 watt rms. Të ketë mundësi kontrolli me RDNet me program kompjuterik për analizën e frekuencave dhe optimizimin e sistemit në distancë. • Boks aktiv për fjalim: Boks dy rrugësh me Boks 10", dhe frekuencë të lartë 1" me amplifikator të integruar. Boksi të ketë fuqi të paktën 500 watt dhe nivel decibel të paktën deri në 122dB. • Pult fonie digjitale me 16 kanale: Pult fonie digjital. Pulti duhet të ketë të paktën 16 hyrje mono, si dhe 16 shina të motorizuara. Pulti të ketë 16 hyrje dhe 8 dalje analoge. Pulti duhet të kontrollohet me protokollin Dante Controller. Pulti të shoqërohet me një "stagebox" (pajisje për ndërlidhje sinjali) i cili krijon mundësi për të shtuar dhe 16 hyrje dhe 8 dalje. Pulti të ketë të integruar një ekran digjital me anë të të cilit të kontrollohen dhe të rregullohen parametra të ndryshëm. Pulti të krijojë mundësinë që të kryejë regjistrim multi-track me 16 kanale. Pulti duhet të krijojë mundësi për procesim zëri në çdo hyrje dhe dalje. • Mikrofon vokali me kabëll: Mikrofon vokali dinamik me kabëll. Polariteti super kardiod. Brezi i frekuencave 50 Hz – 16 kHz. Mikrofonit të jetë i përshtatshëm për t'u përdorur në koncerte dhe këngëtarë live. • Set pajisjesh për DJ. Set pajisjesh për DJ për performancë e DJ

	(cd player + mixer)
Ekran LED me rezolucion jo më shumë se 3.9 mm (për ambient të jashtëm) përmasa paneli 50cmX100cm. Sipërfaqe jo më pak se 150 m² (duke përfshirë laptop, server video, videoproçesor, strukturë mbajtëse për Ekranin Led).	• Ekrani led me rezolucion jo më shumë se 3.9 mm për ambient të jashtëm. Përmasat e një paneli led janë 0.5m x 1m. Jo më pak se 150 m². Ekranit LED është i përshtatshëm për video dhe imazhe të formateve të ndryshme. • Strukturë mbajtëse për Ekranin Led: Strukturë alumini për mbajtje peshe. Struktura të jetë lehtësisht e montueshme dhe e çmontueshme në përmasa të rregulluara sipas kërkesave të ekranit led. • Videoproçesor Proçesor video për përdorimin e Ekranit Led. Proçesori i videos duhet të ketë mundësinë për hyrje dvi, vga dhe usb. • Servervideo. Mediaserver, të ketë të paktën 20 layer full hd 1080p, hyrje video të paktën 1 hd-sdi, 1 hdmi dhe 2 vga. Dalje video të paktën 2 dvi, 1 hdmi dhe 2 vga. • Laptop: Laptop video për të bërë të mundur shfaqjen e imazheve video në Led wall.
Strukturë skenike e çertifikuar për mbajtje peshe dhe punime në lartësi.	• Skeleri amerikane. Skeleri amerikane me përmbajtje alumini me përmasa nga 1m deri në 3m. Struktura mund të mbajë një peshë prej 200kg/m. Struktura të ketë edhe mundësi për t'u varur ose për t'u lidhur. • Strukturë skenike Layher. Strukturë alumini e çertifikuar për mbajtje peshe dhe punime në lartësi. Struktura të jetë lehtësisht e montueshme dhe e çmontueshme në përmasa të rregulluara sipas kërkesave.
Pajisje ndriçimi (ndriçim i kompletuar, jo më pak se 40 dhe 80 njësi ndriçimi. Psh: Ndriçues linear, ndriçues i robotizuar led wash, ndriçues wash rgb, ndriçues me kokë të rrotullueshme, led par, ndriçues statik led profile, mikser ndriçimi profesional, aksesore	• Robot Spot: Roboti të jetë me llampë të paktën 250 watt. Funksioni kryesor të jetë për përdorim Spot, por të mos jetë i limituar edhe për përdorim si Beam dhe Wash. Këndet e zoomit që duhet të suportojë: 2.2 – 24° për Beam, 2.5 – 24° për Spot dhe 15 – 45° për wash. Të ketë të paktën 8 “gobo” të motorizuara dhe 12 gobo statike. Të ketë një prizëm linear me të paktën 4 faqe dhe një prizëm me 8 faqe që rrotullohet. Të ketë të paktën 10 ngjyra të ndryshme, përfshi CTO, CTB, UV. Fokusi të jetë i motorizuar. Roboti të kontrollohet me protokollin DMX. Roboti të vijë me të gjithë aksesoret e nevojshëm që shërbejnë për ta montuar dhe vendosur në

teknikë për montim të sigurtë, etj).	punë. • Robot Beam: Roboti të jetë me llampë të paktën 180 watt. Funkcioni kryesor të jetë për përdorim Beam. Këndi i lentes të jetë 1° - 3.8°. Të ketë të paktën 17 gobo. Të ketë të paktën një prizëm me 8 faqe. Të ketë frost, zoom të motorizuar, fokus të motorizuar. Roboti të kontrollohet me protokollin DMX. Roboti të vijë me të gjithë aksesoret e nevojshëm që shërbejnë për ta montuar dhe vendosur në punë. • Robot wash: Roboti të jetë me LED RGBW me fuqi të paktën 120 watt. Funkcioni kryesor të jetë për përdorim Wash. Intensiteti i dritës të jetë të paktën 2000 Lumen. Roboti të ketë zoom të motorizuar me kënde 10°–60°. Roboti të kontrollohet me protokollin DMX. Roboti të vijë me të gjithë aksesoret e nevojshëm që shërbejnë për ta montuar dhe vendosur në punë. • Ndriçues wash rgb: Ndriçues wash jo i motorizuar dhe të ketë të paktën 4 LED RGB me nga 30 watt secili. Këndi i dritës të jetë të paktën 60°. Ndriçuesi të kontrollohet me protokollin DMX. • Dritë e bardhë mediatike. Ndriçues i bardhë mediatik me fuqi 300 watt me LED. Ndriçuesi të krijojë mundësinë për ndriçim të bardhë të ngrohtë dhe të ftohtë nga 3000k – 8000k. Këndi i ndriçimit 15°-50°. Ndriçuesi të jetë i përshtatshëm për një ndriçim sa më funksional për kamera me cilësi të lartë. • Pult ndriçimi. Mikser ndriçimi me 4 universe (4 x dmx) me mundësi lidhjeje të një monitori nëpërmjet hyrjes VGA ose DVI. Mikseri të ketë aftësinë të mbajë deri në 32 DMX universe dhe deri në 8192 parametra të ndryshëm. Mikseri të ketë mundësinë e dy llampave për të punuar edhe në errësirë. • Dritë skenike (për folësin). Ndriçues skenik RGBW me llampë halogjene 575 watt. Ndriçuesi është i përshtatshëm për të fokusuar në skenë folësin apo këdo që është në skenë. Këndi i ndriçimit është 13° - 19°. • Blitz për efekte speciale. Ndriçues blitz me llampë LED-Xenon 3000 watt. Ndriçuesi është i përshtatshëm për përdorim në koncerte për të krijuar efektin e blitzit. Ndriçuesi kontrollohet nga protokollin DMX. Temperatura e dritës është 5700 K. Ndriçuesi shoqërohet me të gjithë aksesoret përkatës për t'u
---	---

instaluar.

- **Tym skenik.** Pajisje tymi skenik. Pajisja krijon mundësinë që përbërësin fluid përkatës ta kthejë në efekt mjegull. Përdoret për efekte skenike, gjithashtu, për të bërë të dukshme dhe efektet e ndriçimit. Pajisja kontrollohet nga protokolli DMX.
- **Robot WashBeamLED me fuqi llampë led mbi 700 watt.** Roboti të jetë me fuqi llampe mbi 700watt si edhe të përbëhet nga 18 llampa led me mundësi ngjyrash RGBW. Roboti të ketë mundësi të ketë gamë zmadhimi 4° - 50°. Roboti të përbëhet nga 4 unaza LED të kontrollueshme individualisht.
- **Robot BeamLED me fuqi llampë led mbi 450 watt.** Roboti të jetë me fuqi llampe minimalisht 450 watt si edhe të përbëhet nga 12 llampa led me mundësi ngjyrash RGBW. Roboti të ketë mundësi të ketë game zmadhimi 4° - 60°. Duhet të ketë efekt elektronik strobe me shpejtësi të ndryshueshme deri në 20 Hz. Gama e lëvizjes së Pan të jetë 450°. Konsumi i energjisë të jetë maksimalisht 450 W në 230 V / 50 Hz.
- **Robot WASH me fuqi llampë 1200 watt.** Roboti të ketë Llambë shkarkimi 1200W. Të ketë 2x5 gobo rrotulluese të indeksueshme. Të mundësojë efekt strobe 2 - 10 Hz si edhe të ketë efekt zoom dhe fokus të motorizuar. Gama e lëvizjes së Pan dhe Tilt të jetë 540°/267°. Pesha e pajisjes të jetë jo me pak se 40 kg si edhe të mundësojë Focus 2 m deri në infinit.
- **Robot Spot me fuqi llamp 400 watt.** Roboti të ketë llampë me fuqi minimale 400 watt si edhe të ketë një zmadhim që varion nga 4° në 50° (raporti 1:12). Roboti të ketë një fokusim elektronik për një rreze drite të përkryer të mprehtë përgjatë gjithë gjatësisë së saj si edhe të ketë 15 filtra të veçantë me ngjyra. Pesha e robotit të jetë jo më shumë se 35 kg.
- **Robot Hybrid Spot me fuqi llampe mbi 400 watt.** Roboti të ketë një llampë minimalisht 470 wat si edhe 7.500K. Diametri i lentes së robotit të jetë 150 mm. Roboti të jetë i pajisur me 9 gobo të rrotullueshme dhe 14 gobo statike. Roboti të mos konsumojë më shumë se 690 watt.
- **RGB Verbuese/RGB Blinder.** Ndriçues skenik jo i motorizuar për efekte. Ndriçuesi të jetë i përbërë nga mbi 1800 llampa LED RGBW me intensitet drite 5700K. Hapja e dritës maksimale të

	jetë 110°. Temperatura të variojë nga 2000K-10000K. Konsumi maksimal i robotit të mos jetë më shumë se 470W. • Verbues/Blinder. Ndriçues skenik jo i motorizuar për efekte. Ndriçuesi të jetë i përbërë nga 4 llampa 650 watt secila. Ndriçuesi të kontrollohet me protokollin DMX, i përshtatshëm për t'u vendosur në skena dhe ambjente të ndryshme. Ndriçuesi të shoqërohet me të gjithë aksesoret përkatës për t'u instaluar. • Dritë Skenike 1.7kw e automatizuar. Robot spot me fuqi maksimale 1700W. Të jetë i pajisur me llampë 6000K, me kapacitet zmadhimi dhe zvogëlimi të dritës nga 5°-55°. Niveli i ndriçimit të jetë 200.000 Lx në 5 metra distancë. • Robot Profile. Robot i pajisur me llampë LED Multi-Spekter me fuqi 500W, i motorizuar për efektet e zmadhimit dhe fokusimit. Mund të përdoret si dritë mediatike profesionale. Duhet të ketë mundësi për vendosje deri në 6 gobo dhe me kënd nga 7-49°.
Platformë skenike (Stage) me sipërfaqe 60 m ² dhe 120 m ²	• Pedana me lartësi të ndryshme. Panele stage me përmasa 2m x 1m ose 1x1m me mundësi bashkimi me njëra-tjetrën për të krijuar sipërfaqe të ndryshme skene. Panelet janë me bazë çeliku/alumin dhe këmbë të rregullueshme deri në lartësi 1.5m nga toka dhe sipërfaqe të gomuar, antirrëshqitëse. Paneli duhet të suportojë një peshë jo më pak se 500kg- 1000 kg/m².

Shënim : Në të gjitha rastet kur është përdorur fjala markë ose emër, njihet një vlefshmëria /barazvlefshmëria ose ekuivalent.